


### Përshkrimi i kursit


Ky kurs trajnimi trajton hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren për hartimin e një Planit Biznesi 5-vjeçar për shoqëritë ujësjellës kanalizime. Duke filluar nga analizimi i situatës aktuale, identifikimi i objektivat strategjike, konvertimi i tyre në plane konkrete për përmirësimin e performancës deri tek monitorimi dhe përditësimi i këtyre planeve.



Bashkë me këtë kurs është prodhuar dhe një template në Excel, me të cilin duke futur të dhënat për vitin aktual, pjesëmarrësit mund të parashikojnë dhe llogaritnin në mënyrë automatike treguesit e performancës për 5-vitet e ardhshme.

### Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtuesit e departamentit ekonomik, inxhinierikë, shitjes, dhe shërbimit me klientin.



### Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Njihni strukturën, procesin dhe elementët kryesore të planit të biznesit;
- Hartoni vizionin dhe misionin e shoqërisë UK;
- Vlerësoni situatën aktuale dhe identifikoni çështjet prioritare;
- Llogaritni kërkesën aktuale për ujë, parashikoni kërkesën e ardhshme dhe të vlerësoni ujin pa të ardhura;
- Identifikoni problematikat e strukturës organizative dhe të krijoni një strukturë të re të përmirësuar;
- Përcaktoni objektivat strategjike;
- Hartoni një program të plotë planesh veprimi për përmirësimin e performancës;
- Parashikoni buxhetin e operim mirëmbajtjes, shpenzimeve kapitale dhe nevojës totale për të ardhura;
- Identifikoni faktorët që ndikojnë në strategjinë e tarifave dhe përzgjidhni strukturën e përshtatshme të tarifave;
- Programoni kontrollin, monitorimin dhe përditësimin e planit të biznesit;

### Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe ushtrime. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të fillojnë punën për hartimin e planit të biznesit të shoqërisë së tyre.

### Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit për Planin e biznesit për Përmirësimin e Performancës. Përpos kësaj, ju do të pajiseni me certifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

### Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB: 122,000 lekë për 3 persona.

Jo-anëtarët: 132,000 lekë për 3 persona.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe për 4 ditët e trajnimit.

## FORMULAR REGJISTRIMI

**Emër Mbimër** \_\_\_\_\_

**Datëlindja** \_\_\_\_\_

**Institucioni** \_\_\_\_\_

**Pozicioni** \_\_\_\_\_

**Edukimi** \_\_\_\_\_

**Celular** \_\_\_\_\_

**E-mail** \_\_\_\_\_

**Adresa** \_\_\_\_\_

Ju lutem, plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në adresën e e-mailit [training@shukalb.al](mailto:training@shukalb.al).  
Pagesën mund ta derdhni në llogarinë bankare të Shoqatës si më poshtë, duke specifikuar emrin tuaj dhe qëllimin e transfertës:

**Banka:** PROCREDIT, Dega Tiranë

**Emri i Llogarisë:** Shoqata e Ndërmarrjeve Ujësjiellës Kanalizime të Shqipërisë

**Numri i Llogarisë:** 10-831379-00-01

**IBAN:** AL 95209111080000108313790001

***Shënim:** Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet duhet të konfirmohet nëpërmjet e-mailit, telefonit apo postës.*

*Nëse ju konfirmoni dhe mungoni në këtë trajnim pa paparalajmëruar minimalisht 3 ditë përpara, atëherë shuma e plotë e pagesës do tju mbahet.*